

PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në dt. 30.10.2025, në orën 11:00, në sallën e këshillit bashkiak, në Pallatin e Kulturës Lezhë, mbi mbledhjen e radhës të muajit Tetor 2025, të Këshillit të Bashkisë Lezhë.

Mbledhja u hap nga kryetari z. Ndue Luli, i cili lexoi rendin e ditës.

-Ndue Luli: Përshëndetje të gjithëve. Faleminderit për pjesëmarrjen.

Sipas njoftimit që kemi marrë, sot zhvillojmë mbledhjen e zakonshme të Këshillit Bashkiak për muajin tetor, me këtë rend dite:

1. Projekt-Vendim “Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-30 Shtator 2025”
2. Projekt-Vendim “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë, të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2025”
3. Projekt-Vendim “Për një shtesë në Vendimin nr. 74, datë 25.09.2024 “Për miratimin e pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë, të punonjësve administrativë, të punonjësve mbështetës dhe të masës së shpërblimit mujor të këshilltarëve dhe kryetarëve të fshatrave” i ndryshuar”
4. Projekt-Vendim “Për miratimin e hapjes së rrugës “ByPass-i i Shëngjinit”, Njësia Administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë, në fondin pyjor bashkiak”
5. Projekt-Vendim “Për dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor kombëtar të sipërfaqes pyjore në pronësi të bashkisë, për kryerjen e aktivitetit minerar në objektin Gjobardhaj, nga shoqëria “Gjoni” shpk”
6. Projekt-Vendim “Për miratimin e krijimit të një “kafeterie leximi” si dhe dhënies me qira të ambientit me vendndodhje në pjesën anësore në katin e parë të bibliotekës publike “Gjergj Fishta” me sip. 115.6 m² pjesë e pasurisë nr. 9/32, ZK 8631, pronë e Bashkisë Lezhë, për një afat 1 (një) vit”
7. Projekt-Vendim “Për miratimin e marrëveshjes së subvencionimit ndërmjet programit URBACT IV 2021-2027 dhe Bashkisë Lezhë për projektin “URBACT PIONEERS ACCELERATOR”
8. Projekt-Vendim “Për emërtimin e rrugës me nr. 57 03170051 me emrin “Gjergj Kovaçi” në fshatin Tresh, Njësia Administrative Zejmen”
9. Projekt-Vendim “Për emërtimin e rrugës me nr. 46 03170040 me emrin “Jak Kovaçi” në fshatin Tresh, Njësia Administrative Zejmen”
10. Projekt-Vendim “Për emërtimin e rrugës me nr. 60 03170055 me emrin “Pjetër Jak Zefaj” në fshatin Tresh, Njësia Administrative Zejmen”
11. Informacion mbi realizimin e Buxhetit për 9-mujorin e vitit 2025
12. Të ndryshme

Ky është rendi i ditës. Kush ka ndonjë diçka? Fjalën e ka nënkryetari.

-Agostin Marku: Duke parë rendin e ditës, unë i propozoj këshillit që pikën tre të rendit të ditës, projektvendim për një shtesë në vendimin 74, ta heqim nga rendi i ditës, për arsye se, në një farë mënyre, bie ndesh me pikën shtatë që kemi për të miratuar një marrëveshje dhe pas miratimit të kësaj marrëveshjeje i lind e drejta bashkisë për të na sjellë këtë projektvendim i cili ka të bëjë me vendosjen e një page për një menaxher që konkretizon marrëveshjen që është në pikën shtatë. Pra, ta heqim nga rendi i ditës, të miratohet apo s'miratohet, e di këshilli, por në procedurë të rregullt ligjore duhet të miratohet kjo, duhet të konfirmohet tek prefekti, hyn fuqi si vendim, marrëveshja, pastaj i lind e drejta bashkisë për përcaktimin e pagës. Në një farë mënyre dhe në konsultë me drejtuesit e bashkisë, janë dakord në parim, sepse është diçka ligjore dhe i propozoj këshillit që ta heqim nga rendi i ditës.

-Ndue Luli: Faleminderit. Tjetër për rendin e ditës? Kush është dakord që rendi i ditës të kalohet me pikat që lexuam, duke hequr pikën tre? Ju lutem, kartonat. Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 27 vota Pro. Faleminderit.

Vazhdojmë me pikën e parë, projektvendim “Për përdorimin e fondit kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 1-30 Shtator 2025”. Kush është dakord me projektvendimin? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 27 vota Pro. Faleminderit.

Kalojmë te pika e dytë, projektvendim “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë, të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2025”. Kush është dakord me projektvendimin? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 27 vota Pro. Faleminderit.

Kalojmë te pika tjetër, projektvendim “Për miratimin e hapjes së rrugës “ByPass-i i Shëngjinit”, Njësia Administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë, në fondin pyjor bashkiak”.

Në lidhje me këtë projektvendim, duhet të dimë se para shumë ditësh është zhvilluar dëgjesa publike me banorë të zonës, me pjesëtarët e komunitetit. Pjesëmarrja, mund të themi, ka qenë e zgjeruar. Shumë banorë mezi pritnin që të bëhet një gjë e tillë, e cila lehtëson shumë, mund të themi, trafikun. Është diskutuar dhe dje në komision, kështu që e ka fjalën kryetari i komisionit.

-Dod Jaku: Përshëndetje të gjithëve. Komisioni i bujqësisë, ditën e djeshme mori në shqyrtim këtë projektvendim dhe shpreh dakordësinë plotësisht dhe i propozon këshillit bashkiak që ta miratojmë këtë projektvendim. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit ju. Kush ka ndonjë diçka tjetër? Zonja Ndoj.

-Donika Ndoj: Atëherë, përshëndetje të gjithëve. Në fakt, kur bëhet fjalë për rrugë, absolutisht që jemi dakord që të ndërtohen dhe të zhvillohen, por padiskutim që kjo do të ndikojë në lehtësimin e trafikut, sidomos në sezonin turistik, jo se do t'i japë një zgjidhje problemit të trafikut për Shëngjinin. Shëngjini ka nevojë për rrugë, por dhe për një zhvillim të qëndrueshëm. Duke qenë se bëhet fjalë për një bypass, për një segment rruge, por ajo që mund të them unë është se, pyetja që mund të them unë është: a është bërë një studim i mirëfilltë i mjedisit në

pjesën e fundit pyjor, pasi shpesh, duke qenë dhe një relief pak kodrinor, mund të ndeshim edhe probleme të erozionit, çka është një problem serioz, dhe cilat janë afatet e këtij projekti? Si do të monitorohet ky projekt për të shmangur abuzimet, kur ka një fillim apo një fund ky projekt? Për sezonin, bëhet fjalë nëse do të jetë gati për sezonin turistik të vitit të ardhshëm. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit ju. Në lidhje me përgjigjen e pyetjes, drejtori i urbanistikës e ka fjalën.

-Flamur Kuçi: Atëherë, projekti ka një raport vlerësimi të ndikimit në mjedis që bëhet nga ekspertë të licencuar, është i depozituar dhe është depozituar para se sa është dhënë leja e ndërtimit. Ndërsa në lidhje me pyetjen e dytë, afati zyrtar është 18 muaj, pavarësisht se në komunikim me kompaninë është bërë një lloj presioni që rruga të hapet brenda sezonit të ardhshëm turistik.

-Ndue Luli: Faleminderit. Diskutim? Zonja Sokolaj.

-Regjina Sokolaj: Faleminderit. I nderuar kryetar i këshillit, të nderuar anëtarë të këshillit bashkiak. Sot kemi përpara një projekt që shkon përtej inxhinierisë dhe betonit. Është një projekt që prek vetë frymëmarrjen e qytetit tonë. Bëhet fjalë për ndërtimin e rrugës Bypass të Shëngjinit, një hap drejt një Lezhe më të lidhur, më të qetë dhe më të qëndrueshme. I madhi Hugo shkruante: "Qytetet janë si librat. Kush i lexon me vëmendje, kupton shpirtin e një kombi." Duke ndërtuar më mirë, ne nuk ndërtojmë vetëm rrugë, por faqe të reja në librin e zhvillimit tonë të qëndrueshëm. Ky bypass nuk është thjesht një aks i ri rrugor, por është një frymëmarrje për jetën tonë të përbashkët. Natyrisht që do të lehtësojë trafikun që rëndon Shëngjinin në verë, do të ulë ndotjen, do të rrisë sigurinë për banorët dhe për vizitorët. Por mbi të gjitha, do të krijojë lidhje mes njerëzve, mundësive e pse jo dhe shpresës. Përfitimet prej tij janë të prekshme: zhvillim ekonomik, sepse çdo rrugë e re është si një damar që sjell energji pozitive në trupin e qytetit; punësim, sepse çdo projekt i madh është një mundësi për punë dhe dinjitet; modernizim urban, sepse një qytet që ecën me kohën fiton besimin e të rinjve për të qëndruar dhe për të ndërtuar këtu të ardhmen. Dhe mbi të gjitha, ndikimi në turizëm është thelbësor. Shëngjini, kjo perlë e Adriatikut, meriton një infrastrukturë që i jep dinjitet bukurisë së tij natyrore. Me bypass-in, i jepet mundësi më shumë vizitorëve të zbulojnë jo vetëm detin, por edhe shpirtin e kësaj zone. Asgjë që ndërtohet nuk do të zgjasë nëse nuk ndërtohet me kujdes për njerëzit. Prandaj, vlen të përmendet kujdesi i Bashkisë Lezhë dhe drejtorisë së planifikimit të territorit e zhvillimit urban për punën dhe përkushtimin e treguar në realizimin e këtij projekti. Identifikimi i pronave, përgatitja e dokumentacionit, sigurimi i fondeve janë dëshmi faktike e një administrate që punon me transparencë, vizion dhe efikasitet për të mirën e qytetarëve. E ardhmja fillon sot, jo nesër. Ky projekt është një akt përgjegjësie në të tashmen ndaj të ardhmes sonë të përbashkët. Mbështetja e këtij projekti u hap rrugë përfitimeve afatgjata për komunitetin, në rrugë më të lira, në ajrin më të pastër dhe në një qytet që rritet me ritmin e kohës. Ndaj, ju ftoj ta mbështesim këtë projekt si një investim në njerëz, në besim dhe në zhvillim. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Fjalën e ka zonja Marku.

-Alfrida Marku: Faleminderit për fjalën. Nuk i heq asnjë presje asaj çfarë sapo tha Regjina. Por na kujton më së shumti se kaq me rëndësi është bypass-i i Shëngjinit, sa në 12 vite qeverisje, ne në fakt po shohim se miratimi është më shumë vonesë. Pse e them këtë? Ky projekt, siç edhe e kam theksuar në dëgjuesën publike, i është paraqitur qeverisë shqiptare për miratim dhe financim, të paktën para tetë viteve. Por përballë faktit që ky projekt tashmë ka marrë dritën jeshile për financimin dhe për nisjen e zbatimit, ndikimi në interes publik është ajo çfarë ka rëndësi sot. Pavarësisht se unë nuk mund të rri apo nuk mund të hesht, pa përmendur faktin se ky investim kaq i rëndësishëm i është dhënë Lezhës shumë vonë. Dhe në gjykimin tim për faj dhe për përgjegjësi shumë të madhe të politikës së të dy krahëve, që shpesh herë është edhe boshe, nga njëra anë ne kemi ata që janë në pushtet tash 12 vite, që harrojnë se investimet e mëdha kryhen me taksat e qytetarëve dhe harrojnë se janë aty për të kryer pikërisht këto investime. Por nga ana tjetër, me keqardhje më duhet ta pranoj, janë ata që janë në opozitë që rrugës kanë harruar se duhet të jenë alternativë me propozime konkrete, të mirëfillta, në parlament atëherë kur diskutohet buxheti. Por për ta tejkaluar këtë moment, unë e vlerësoj jashtëzakonisht shumë miratimin e financimit dhe nisjen e procedurave për zbatimin e bypass-it të Shëngjinit. Absolutisht që ky projekt, duke uruar që do zbatohet në afat, bashkë me aksin Milot-Balldren do i japin Bashkisë së Lezhës rëndësinë e merituar, por sidomos vijës bregdetare, por më lejoni që krahas kësaj që po them, të shtoj e të adresoj dy problematika që i kam përmendur edhe gjatë dëgjuesës publike. Siç edhe është theksuar, gjurma e kësaj rruge do të prekë edhe disa prona private dhe pavarësisht se procedura e shpronësimit dhe kompensimit nuk është kompetencë dhe detyrim i bashkisë, unë mendoj dhe gjykoj se Bashkia Lezhë, për sa kohë që këta banorë jetojnë në territorin e saj dhe këto prona janë në territorin e saj, ka detyrimin që ta adresojë në autoritetet përgjegjëse që kompensimi i këtyre pronave të bëhet minimalisht në vlerat e çmimeve të reja të referencës që priten të miratohen, sepse siç dihet ka një diferencë shumë të madhe mes çmimeve zyrtare të referencës dhe çmimeve reale në treg. Është dhe një problem tjetër që më shumë se sa, mos ma merrni si kritikë, ju thatë që është kryer një dëgjuesë publike, në fakt është ezauruar një dëgjuesë publike por jo në mënyrën më të mirë të mundshme. Dhe unë këtu kërkoj vëmendjen e drejtuesve të këshillit bashkiak që jo vetëm në këtë rast por edhe në dëgjesa të tjera, t'i japim rëndësinë e duhur komunikimit dhe konsultimit me qytetarët dhe grupet e interesit. Pse e them këtë. Pavarësisht se unë jam dakord që ky projektvendim të miratohet, duke njohur të mirat që do të sjellë për Lezhën, unë mendoj që ne si këshill bashkiak duhet ta kishim trajtuar dëgjuesën publike ndryshe. Ta zhvillonim minimalisht në zonën e Shëngjinit dhe në mënyrë të detyruar të ishin pjesë e kësaj dëgjese publike edhe ato familje të cilat preken për efekt shpronësimi nga periudha e këtij projekti. Për ta përmbyllur, unë uroj që për projekte të rëndësishme kaq të madhe, Lezha të mos jetë e fundit në vëmendjen e qeverisë, por që nga ana tjetër unë uroj që për investimet e rëndësishme kaq të madhe, politika të mos jetë kaq në rrugë të gabuar, kur vjen puna pse jo, edhe për të gjetur gjuhën e përbashkët në mënyrë konstruktive për të adresuar aty ku duhet dhe si duhet problematikën. Regjina përmendi një shprehje të Hugoit; unë do të kujtoj një shprehje shqiptare: "Njëri gozhdës, e tjetri patkojit." Kështu më duken, të tregohem e singertë, ata që sot përfaqësojnë Lezhën dhe që duhet të adresojnë këto projekte madhore në buxhetin e qeverisë. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit ju. Zoti Marku.

-Agostin Marku: Duke parë rëndësinë e këtij projekti, edhe komisionet dhe ishin të gjithë krah, pavarësisht bindjeve, për ta miratuar dhe për ta miratuar sa më shpejt. Pajtohem edhe me idenë se është disi vonë, po më mirë vonë se kurrë. Më vjen mirë që nganjëherë zonja Frida na bie në vëmendje edhe krahët e politikës. Dhe në këtë rast, ajo pranoi që të dy krahët e politikës kanë gabuar. Krah i politikës që ka ikë, ka gabuar. Krah i politikës që është, nuk po gabon sepse don të qeverisë prapë. Dhe e ka sjellë në vëmendje. Dhe po i ka siguruar fondet. Dhe ne, si këshill bashkiak, por edhe vetë bashkia, është shumë e vëmendshme, është shumë sensibil, është shumë kërkuese për të sjellë këto projekte në infrastrukturën e Lezhës, sepse e njeh mjaft mirë problematikën. Dhe duke qenë shumë kërkuese, qeveria i ka akorduar, dhe po bashkia, dhe këshilli i bashkisë, edhe ne të gjithë së bashku po kontribuojmë që në mënyrë sa më të shpejtë t'i hapim rrugë këtij investimi strategjik për Lezhën, duke uruar dhe besuar tashmë se edhe investimi tjetër po aq strategjik, që ndoshta edhe për opinionet tona që shpesh herë themi: "Vjedhje, vjedhje, vjedhje, vjedhje," është spostuar disi në kohë, që është edhe rruga, pra autostrada Milot-Baldren, që të gjitha këto bashkë, këto investime strategjike do të ndihmojnë Lezhën, jo të jetë në rendin e të gjithë zonave të tjera, por të jetë pararojë edhe për atë që i ka falë Zoti dhe natyra, që është bregdeti i Shëngjinit dhe i Tales. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Zoti Ndreca.

-Erin Ndreca: Përshëndetje të gjithëve. Ajo që doja të shprehja për këtë projektvendim, në mënyrë po themi më popullore, në fakt e kam dhe për vete dhe për disa të tjerë qytetarë që kam diskutuar, të na bëhet një shpjegim i thjeshtë, por unë nuk kam qenë në dëgjuesë. Dhe meqë kjo mbledhje ka një audiencë më të gjerë për faktin që jemi edhe online, të na bëhet një shpjegim nga ana e drejtorisë, në gjuhë popullore, ku kalon ky bypass, ku fillon dhe ku mbaron, sepse thjesht patjetër që i kemi të përcaktuara në shkresë dhe në relacion me harta dhe me numra, por në gjuhë popullore, "Lidhet atje dhe del këtu." E para.

E dyta, jam dakord. Patjetër dhe nuk e dyshoj që vendimet e shpronësimit do jenë në raport me ligjet aktuale, por që kërkesa e zonjës këshilltare është shumë e drejtë dhe të shikohet me kujdes kjo gjë.

Dhe e treta që dua ta them, jo për replikë, mendoj që qeveria nuk e ka lënë pas dore zonën e Shëngjinit, zonën e Lezhës. Faktet flasin. Kemi rrugën Shëngjin-Velipojë, kemi rrugën e Kunes. Jo të gjitha, kemi diskutuar disa here, jo të gjitha realizohen, por siç e tha dhe Gusti, qeveria ka në mend të punojë, po siguron fondet dhe për ta mbyllur me shprehjen e zyshës, e ardhmja vazhdon sot, nesër do jetë akoma më vonë se sot. Prandaj ju ftoj që ta mbështesim këtë projektvendim.

-Ndue Luli: Faleminderit. Para se sa të japim një përgjigje të shkurtër, po shterruese mund ta quajmë, edhe këshilltarit Ndreca, dy gjëra kisha unë në lidhje me dëgjuesën publike për të cilën ngriti zonja Marku. Dëgjesa publike për këtë investim të rëndësishëm që bën Fondi Shqiptar i Zhvillimit me vendim të qeverisë shqiptare është një investim i cili realizon pikërisht ato që thatë

ju, dhe s'kam pse t'i shtoj asnjë gjë, sepse dihet se çfarë të mirash ka. Por ka qenë një nga dëgjesat publike, mund ta quaj, me pjesëmarrje shumë të madhe dhe me banorë të zonës. Dëgjesat publike është mirë të bëhen atje ku ndodh investimi, por kur thirren persona të cilët janë banorë të asaj zone në një vend tjetër, siç ishte për shembull biblioteka e qytetit, kjo s'do të thotë gjë, që vetëm duhet bërë në vend. Është bërë tamam në vendin e duhur dhe në kohën e duhur, dhe mund të them se ka qenë një nga dëgjesat publike tamam e realizueshme. Unë e kam ngritur te dëgjesa publike dhe po e ngre prapë këtu para jush si këshilltar, por edhe për gjithë komunitetin, që në dëgjesat publike komuniteti i Lezhës dhe edhe i Shqipërisë mund ta quaj, po i Lezhës, është shumë indifferent, gjë e cila lë që secili nga banorët e Bashkisë Lezhë duhet të ndërgjegjësohet se kur bëhet një dëgjesë publike për problematikat të cilat kanë të bëjnë direkt me vetë komunitetin, duhet të jenë pjesëmarrës. Se kështu do të merren të gjitha ato problematika që kanë të bëjnë edhe me investimin që bën qeveria. Madje më erdhi shumë mirë që një nga banorët e Malit të Rrencit ishte pjesëmarrës dhe bëri një pyetje me të drejtë që a do kemi ne akses dalje, meqenëse jemi banorë dhe jemi pak banorë që banojmë atje, po a do kemi akses dalje në këtë rrugë që do të hapet? Dhe përgjigjja e drejtorit të urbanistikës ishte se patjetër që do të jetë, sepse është për të mirën e komunitetit. Për atë po hapet, nuk po hapet për me kalu kafshët e egra atje. Po me kalu njerëzit, me kalu makinat, me lehtësu trafikun në Shëngjin, që e dimë ne se si bëhet, mund të themi sidomos gjatë verës. Pra kjo është që po e cilësoj. Megjithëse për gjëra të tjera dhe më të vogla, unë jam shumë dakord që dëgjesa publike të bëhet në lagjen përkatëse për të cilat nuk kanë munguar dëgjesa të tilla nga këshilli bashkiak. Këshilltarja në fjalë që e ngriti këtë është shumë aktive për sa i përket pjesëmarrjes në dëgjesat publike, edhe ne sa herë që thirret, kjo është diçka shumë e mirë për këshilltaren, por edhe për disa të tjerë. Po kemi edhe këshilltarë të tjerë të cilët duhet të ndërgjegjësohen më shumë, të jenë më aktivë, të jenë më pjesëmarrës, të marrin zërin e komunitetit, ta sjellin këtu. Dhe kështu bëhet edhe dëgjesa publike. Fjalën e ka zëvendëskryetarja e bashkisë.

-Brikena Vuksani: Përshëndetje të gjithëve. Ju faleminderit të gjithëve për sugjerimet tuaja dhe për komentet në lidhje me projektvendimin në fjalë. Unë desha të sqaroj diçka në lidhje me atë që tha zonja Marku përpara, në lidhje me projektin që keni pasur ju para tetë viteve. Dua të sqaroj dhe këshilltarët që projekti është bërë nga Bashkia Lezhë para dy viteve. Ajo që keni pasur ju ka qenë një projekt ide. Projekti i bypass-it të Shëngjinit është bërë nga Bashkia Lezhë para dy viteve dhe është miratuar te Fondi i Zhvillimit. Edhe kërkesa për fond është bërë po nga Bashkia Lezhë. Pjesa tjetër në lidhje me çmimet e referencës, siç e dimë, baza ligjore për çmimet e referencës akoma nuk ka hyrë në fuqi. Ka akoma sugjerime dhe mendime, nuk e dimë nëse do hyjë në fuqi më 1 janar apo jo, sepse nga komunikimet që kemi bërë edhe para një jave me ministrinë, mund edhe mos të miratohet dhe të hyjë në fuqi me datën 1 janar. Ne për këtë pjesë, edhe ne jemi dakord, do bëjmë sugjerimet tona si bashki dhe presim që të miratohen që me çmimet e reja të referencës të fillojë edhe procedura e shpronësimit për banorët në fjalë që preken nga ky projekt. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit ju.

-Erin Ndreca: Shkurtimisht, fillon këtu, kalon aty, kaq, tre gjëra.

-Ndue Luli: Atëherë fjalën e ka nënkryetari i bashkisë.

-Fatjon Zefi: Atëherë. Ky është ndër rastet, ndër projektet që ka qenë shumë i saktë, edhe raporti i shpronësimit është bërë shumë i saktë dhe nuk do të ketë asnjë cungim të këtij realizimi të këtij projekti. Pra, nuk do të ketë devijime, sepse çdo metër katror do shpronësohet sipas pronësisë që kanë dhe sot jemi mbledhur për ta hedh në fondin pyjor dhe rëndom ne bëjmë projekte të ndryshme në lidhje me fondin pyjor dhe nuk e kuptojmë sensin. Ne bëjmë hedhjen në fondin pyjor, sepse kemi një listë inventarësh të pyjeve dhe në rast se na kërkohet nga ministria ose në rast se kërkojmë që të bëjmë një investim të ri, ne duhet t'i pasqyrojmë këto investime të reja, t'i pasqyrojmë fondet pyjore që të kemi një database sa më të saktë. Projekti fillon, po e them kështu që ta kuptojnë të gjithë, rruga Lezhë-Shëngjin fillon përtej La Sperancës që ka qenë gurorë, ngjitet direkt në mal në Kodemalekaj dhe vazhdon e lidhet gjithkund vijës malore deri tek rruga Shëngjin-Velipojë do ndërtohet një rotondë pra i bashkohet asaj rruge. Të gjithë ata që janë për Ranë të Hedhun ose për Velipojë shmangin komplet trafikun e Shëngjinit dhe ngjiten direkt atje. Rruga do jetë dykalimëshe dhe ka kriteret që nuk ka nevojë që të hiqet nga fondi pyjor, thjesht do pasqyrohet në fondin pyjor. Pra, nuk është e gjërësisë që të hiqet komplet. Raportin e shpronësimit po e ndjek drejtoria juridike, do t'i drejtohet autoriteteve përkatëse.

-Ndue Luli: Zonja Marku për një sqarim.

-Alfrida Marku: Se ne edhe rëndësinë kur gjejmë zgjidhje, pra kur ka zgjidhje për Lezhën, gabojmë shpesh herë dhe e kufizojmë tek qasja personale. Pra, secili prej nesh këtu, Kur mos të flas në emër personal, por të flas në emër të individit dhe për projekte dhe investime t'i adresojë në emër të institucionit dhe në të mirë të qytetarëve, pra të mos e lidhë institucionin me veten, por institucionin me qytetarët, atëherë mendoj se do të gjejmë patjetër zgjidhje. Unë nuk diskutova më herët për të ndarë autorësinë e projektit. Edhe unë sugjeroj përfaqësuesve të bashkisë që të mos ia heqin rëndësinë miratimit të këtij projekti duke e kufizuar tek individi, pra tek individualja. Gjithçka bëhet në emër të institucionit të bashkisë, nuk është në emër të individit, por është për të mirën e publikut. Pse e them këtë? Është e vërtetë që edhe para 7-8 viteve është paraqitur këshillit të ministrave për miratim financimi i bypass-it të Shëngjinit. Por miratimi nuk ka ardhur si rezultat i mungesës së vullnetit të qeverisë në atë kohë për t'i hapur rrugë zgjidhjes së kësaj problematike shumëvjeçare për Lezhën. Kështu që për mua e rëndësishme është që kjo problematikë ka marrë zgjidhje. Unë nuk jam këtu për të ndarë autorësinë e projektit, ama nuk mund të lejoj që përgjegjësitë institucionale të kufizohen tek individët. Institucionet janë të qytetarëve, buxheti i qeverisë është në shërbim të qytetarëve, buxheti vendor është në shërbim të qytetarëve. Kështu që për t'i dhënë edhe vetes ju autoritetin që ju përfaqëson, që përfaqësoni, duhet patjetër që të flisni në emër të institucionit, në të mirë të qytetarëve dhe jo projekti juaj, projekti im. Nëse flasim me këtë gjuhë, ai projekt ka qenë edhe i jotë, sepse ke qenë ndër pjesët më të mira të institucionit të bashkisë në atë kohë, ashtu sikurse vazhdon të jesh dhe sot. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit ty, por zgjati pak sqarimi. Megjithatë të jemi më konçizë. Dy herë këshilltari për të njëjtin problem.... Hera e dytë është për replikë. Një minutë, dy dhe mbaroi puna.

Atëherë ka kush ndonjë mendim tjetër? Nuk ka.

Kush është dakord me projektvendimin? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë. Faleminderit.

Kalojmë te pika 5, projektvendim "Për dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor kombëtar të sipërfaqes pyjore në pronësi të bashkisë, për kryerjen e aktivitetit minerar në objektin Gjobardhaj, nga shoqëria "Gjoni" shpk".

Në lidhje me këtë, siç e dini, janë mbledhur komisionet dhe. Komisioni i Bujqësisë ka funksionuar. Fjalën e ka kryetari i komisionit.

-Dod Jaku: Përshëndetje të gjithëve. Komisioni i Bujqësisë i mbledhur dhe mori në shqyrtim këtë projektvendim dhe doli me vendimin që t'i propozojë këshillit bashkiak për shtyrjen e këtij projektvendimi në mbledhjen e ardhshme, për të pasur një informacion më të plotë në lidhje me të ardhurat dhe përfitimet që sjell ky aktivitet në këtë zonë. Kështu që ne i propozojmë këshillit bashkiak që këtë projektvendim ta shtyjë për mbledhjen e ardhshme. Ju faleminderit.

-Ndue Luli: Po, zoti Ndreca.

-Erin Ndreca: Përshëndetje edhe njëherë. Komisioni ka detyrën e tij të pazëvendësueshme për diskutime, për gjykime, por unë e kam lexuar relacionin dhe jam me atë idenë që përderisa një projektvendim është shqyrtuar nga organet kompetente të bashkisë dhe përderisa aty lexohet që është një miratim i dërguar dhe shqyrtuar dhe nga Ministria e Mjedisit dhe duke qenë se bëhet fjalë për një investim në një zonë ku do sjellë zhvillim, ku do sjellë punësim të asaj zone, sepse siç jemi të gjithë të vetëdijshëm se zonat malore, zonat e thella, po vijnë gjithmonë dhe drejt shpopullimit për arsye të mungesës së punësimit, unë ju ftoj që ta shikojmë dhe njëherë këtë vendim që të mos t'i vështirësojmë bizneset për arsye që ne mbase dhe nuk jemi aq kompetentë sa bashkia apo ministria që e ka sjellë këtë vendim. Megjithatë ky është mendimi im dhe unë i respektoj organet kompetente. Dhe unë mendoj që ky projektvendim të shikohet dhe të hidhet në votim sot. Megjithatë, nëse ka diskutime të tjera, t'i dëgjojmë.

-Ndue Luli: Mirë. Një sekond, ju lutem. Këtu ka një propozim të komisionit të këshillit bashkiak, ku veprimtaria e komisioneve dihet nga gjithë ne se kur ka kuorumin e domosdoshëm për të bërë një mbledhje komisioni, propozimet që vijnë nga komisionet vërtet duhet të mbahen në konsideratë, sepse këtu supozohet dhe e vërteta kështu qëndron, që komisioni është marrë me këtë projektvendim, e ka parë më me hollësi ndoshta se dikush nga ne, anëtarët e tjerë të këshillit. Dhe që unë do të hedh në votim propozimin e komisionit të këshillit bashkiak, meqënëse e ka pasë kuorumin. Para se ta hedh në votim, do u jap fjalën shkurtimisht secilit nga ata që duan të diskutojnë. Nënkryetari i bashkisë e ka fjalën i pari.

-Fatjon Zefi: U mundova ta prek pak edhe te projektvendimi tjetër, këtë pjesë. Besoj se kemi qenë shumë objektivë në vlerësimin e këtij projektvendimi, sepse vetë titulli thotë: "Dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor." Subjekti përkatës e ka të shqyrtuar gjithë dokumentacionin nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Infrastrukturës dhe Energjisë. I ka marrë të gjitha lejet përkatëse për shfrytëzimin e mineraleve. Aktualisht ata punojnë, ata e shfrytëzojnë dhe ajo që bëjmë ne është që këtë fond pyjor ne sot realisht nuk e kemi më. Ne do bëjmë vetëm pasqyrimin në fondin pyjor, do ta heqim dhe vijimin e procedurave do të thotë që pastaj kompania do të bëjë një kompensim ndaj bashkisë për këtë heqje fondi pyjor që tashmë e ka kryer dhe vazhdon ta shfrytëzojë, do të bëjë pagesën përkatëse që do të shkojë për mbarështimin e pyjeve në një zonë tjetër. Pra, ne sot nuk pengojmë procesin e kompanisë në qoftë se nuk e votojmë. Ne jemi në vijim të procedurave për ta hequr nga fondi, për ta hequr nga lista e inventarit që bashkia ka. E dyta, lejet ky subjekt i ka marrë para daljes së VKM-së, ku pyjet i kishte Ministria e Bujqësisë. Sot të gjitha pyjet i janë transferuar bashkisë dhe është një kërkesë e vetë ministrisë që thotë që këtë fond pyjor e kemi miratuar, pra po e shfrytëzon aktualisht. Ti s'e ke si bashki sot. Nuk është më pyll. Nuk e shfrytëzon. Nuk e ke, nuk ekziston. Atëherë do ta heqësh dhe do t'i marrim, do t'i vjelim një pagesë përkatëse këtij. Komisioni është munduar me dëshirën e mirë. S'kam qenë prezent në komision, por më është thënë se çfarë investon subjekti për komunitetin. Investimi është punësimi i banorëve të zonës.

-Dod Jaku: Ne nuk kishim një informacion se çfarë të ardhurash dhe përfitimesh ka komuniteti dhe bashkia. Nuk jemi kundra zhvillimit të aktivitetit nga ana e subjektit. Në komision dje u diskutua shumë gjerë me aq sa kishim informacion. Ndoshta shumë nga këto informacione që thotë nënkryetari, ne nuk i dinim dje dhe nuk i kishim. Por komisioni doli t'i propozojë këshillit bashkiak që të kishim një informacion edhe më të saktë e më të mirë se çfarë përfitimi mund të ketë komuniteti dhe bashkia nga ky subjekt. Pa paragjyku subjekt, pa paragjyku dhe për të dashtë me kriju frenime në zhvillimin e një aktiviteti që është shumë e domosdoshme dhe ne do t'i ndihmojmë investitorët dhe t'i përkrahim e t'i mbështesim me të gjitha mundësitë që kemi. Ishte një sipërfaqe e konsiderueshme. Ishte një sipërfaqe 6 hektarë. Nuk ishte sipërfaqe e vogël. Këtë qëllim pati komisioni dje. Prandaj doli me këtë propozim. Faleminderit.

-Fatjon Zefi: Ky informacion që po jap unë sot është dhënë edhe gjatë dëgjësës publike dhe është edhe këtu në relacionin përkatës që është kryer nga drejtoria përkatëse. Edhe këto vendimet e ministrive janë të bashkangjitura me relacionin. Pra, të gjitha kanë qenë prezente në relacion. Nuk është se nuk janë. Janë të sqaruara edhe detyrimet që do ketë subjekti në vazhdim. Pra, për të na bërë kompensimin. Kështu që në relacion janë të gjitha të sqaruara. Është bërë edhe raporti teknik.

-Ndue Luli: Faleminderit, nënkryetar. Fjalën zonja Marku.

-Alfrida Marku: Faleminderit për fjalën. Unë e gjej të arsyeshme që të shpjegoj qëndrimin tim, sepse jam pjesë e komisionit të bujqësisë edhe këtë projektvendim e shoh shumë të rëndësishëm. Së pari, sqaroj paraprakisht se gjithmonë ndaj qëndrimin që ne duhet të mbështesim sipërmarrjet, si dhe të gjitha lehtësitë, qoftë këto që vijnë nga niveli qendror apo në nivel vendor. Por ajo që

nuk më pëlqen nga diskutimi i deritanishëm, sidomos nga zoti nënkryetar i bashkisë, është se ne anashkalojmë atë për të cilën përpiqemi shumë, autonomia vendore. Le të jetë ajo procedurë e cilësdo qoftë ministri. Kjo është pronë e Bashkisë Lezhë. Këshilli i bashkisë ka të drejtën që të marrë vendime për çdo pronë të Bashkisë Lezhë dhe çdo vendimmarrje e jona sjell pasoja dhe ne mbajmë përgjegjësi për pasojat që sjellim kundrejt komunitetit. Kështu që unë sugjeroj që fjalinë: Kjo praktikë është adresuar apo na ka ardhur në mënyrë zyrtare nga ministria X, ne duhet ta anashkalojmë për sa kohë pretendojmë që të shkojmë drejt autonomisë vendore. Në të kundërt, pranojmë nënshtrimin ndaj institucioneve qendrore. Gjatë mbledhjes së komisionit, ne kemi mbajtur në unison qëndrimin se kjo praktikë i duhet rikthyer bashkisë për rishikim për dy momente themelore. Së pari, ne të kemi një pasqyrë të subjektit, një pasqyrë të të dhënave financiare të subjektit, një pasqyrë të projektit dhe pritshmërive financiare që ky subjekt ka në lidhje me këtë projekt që do të zbatohet në njësinë Ungrej, sepse nuk janë pak, janë 67.000 m² sipërfaqe pyjore që do vihen në dispozicion të këtij subjekti. Por nga ana tjetër, dhe që e shoh shumë të rëndësishme, unë mendoj që midis së drejtës së subjekteve për të kërkuar përdorimin e pronës publike dhe të drejtës së qytetarëve për të marrë në këmbim të mira dhe investime nga prona e tyre publike, pra theksoj këtu ajo sipërfaqe pyjore është në pronësi e banorëve të Lezhës, duhet të ruhet proporcionaliteti i arsyeshëm. Pse e them këtë? Në këto raste, ne duhet që ne si këshill bashkiak t'i sugjerojmë Bashkisë Lezhë që t'i vendosë kushte këtij subjekti. Thënë shkurt edhe shqip: "Dakord, unë po të jap mundësinë që ta shfrytëzosh këtë sipërfaqe pyjore, ama në proporcion me fitimin vjetor që ti realizon nga ky aktivitet, duhet t'ua kthesh qytetarëve në investime në infrastrukturë, në rrugë, në shkolla apo kudo ku të ketë nevojë në zonën e Ungrejt." Kjo do të ishte një zgjidhje e mirë. Unë mendoj që jo më pak se 10% e fitimit subjekti duhet ta kthejë në të mirë të komunitetit. Kjo më pas i mbetet bashkisë për ta gjykuar dhe për ta vlerësuar. Por i qëndroj përfundimisht asaj që kryetari i komisionit shprehu në fillim, propozoj që ky projektvendim t'i kthehet bashkisë për rishqyrtim, për të rishikuar kushtet që negocion me subjektin, gjithmonë duke mos paragjykuar aspak procedurën. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Tjetër? Zoti nënkryetar.

-Fatjon Zefi: E kuptoj dëshirën e mirë të këshilltares për të ndihmuar komunitetin edhe bashkinë, por besoj se po i shmangemi komplet objektivitetit të këtij projektvendimi. Edhe një herë, ne jemi për vijimin e procedurës, domethënë ne nuk jemi sot pronar, sepse pronar ka qenë vetë ministria e pyjeve në momentin që e ka pajisur me këto leje. Dhe sot po të thotë: "Bëj faturën që fatura është e rregulluar me VKM," nuk mund t'i themi ne: "Na jep ti 10% e fitimit," sepse ne nuk mund të prodhojmë ligje. Nuk jemi ligjberës këtu. Nuk jemi në të njëjtat kushte. Prandaj, të marrim me objektivitet projektvendimin dhe të shqyrtojmë atë të cilën kemi kërkuar sot.

-Ndue Luli: Fjalën zoti Ndreca.

-Erin Ndreca: Tani, ndërhyrja ime ishte pasi dëgjova kryetarin e komisionit. Çfarë do të thotë? Do të thotë që, pa dashur për të keqkuptuar apo për të ndryshuar atë që tha kryetari i komisionit. Që kanë rënë dakord, e kanë shqyrtuar, por ka mungesë informacioni. Dhe unë kërkoja që, nëse

kjo mungesë informacioni është e mundur që të merret sot, sepse nuk është projektvendimi i parë që ka një kërkesë nga ana e komisioneve të këshillit bashkiak. Është sqaruar dhe është marrë ky informacion dhe gjatë mbledhjes së këshillit. Dhe kërkesa ime ishte kjo: që nëse bëhet fjalë që ne jemi dakord si komision, por na mungon ky informacion dhe këtë informacion strukturat e bashkisë na e japin sot, pse ne si këshill bashkiak t'i ndërlikojmë gjërat, t'i shtyjmë gjërat, të mos u japim mundësinë për zhvillim gjërave, se pak përpara thamë një rrugë që po na vjen vonë. Fajin e ka X-i apo Y-i më lart. Po dhe një investim që shtyhet, fajin e kemi ne për një informacion që mund ta kemi sot, por nuk e duam sot. Dhe mendoj që nënkryetari i bashkisë këtë informacion sapo e dha. Ne nuk mund të themi, dhe aq më tepër tha që është bërë dhe gjatë dëgjësës publike. Ne nuk e kemi luksin, prandaj unë marr si shembull ministrinë apo organet kompetente të bashkisë që të themi për proporcionalitet sa t'i japim apo sa mos t'i japim. Këtë mendoj që më mirë se ministria apo më mirë se vetë organet e bashkisë nuk e bëjmë dot ne. Ne kemi në dorë të japim mendimin tonë me votë, por jo që të themi ne i takon aq apo i takon kaq, se kjo nuk besoj që ndonjëri nga ne është specialist i diçkaje të tillë. Dhe ne si këshill jemi për të marrë vendime për të mirat e komunitetit, jo t'iu shtyjmë këto të mira kur ne e kemi mundësinë. Patjetër pa asnjë diskutim, jam shumë dakord nëse nuk do ta kishim këtë informacion nga bashkia sot, patjetër që ta marrim. Por nëse ne e marrim, atëherë pse ta shtyjmë? Gjithsesi, ky është mendimi im.

-Ndue Luli: Faleminderit zoti Ndreca.

Fjalën e ka drejtori i bujqësisë, të lutem shkurt. Atëherë, përgjegjësi i sektorit pyjor.

-Artan Palushi: Përshëndetje. Artan Palushi, përgjegjës i sektorit të menaxhimit të pyjeve e kullotave në drejtorinë e bujqësisë. Atëherë, siç u artikulua më parë edhe nga zëvendëskryetari i bashkisë, kemi të bëjmë me një procedurë tërësisht ligjore që mbështet në ligjin 57 të vitit 2020 për pyjet dhe VKM-në 888, datë 27.12.2022, që është për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit të territorit. Që konkretisht me këtë projektvendim që ne kemi sjellë në këshill, kemi të bëjmë me ndryshimin e kategorisë, që nënkupton heqjen e pyllit dhe kthimin e sipërfaqes së dhënë tashmë me leje minerare nga Ministria e Infrastrukturës dhe Ekonomisë dhe kthimin e saj në karrierë guri, pra nxjerrjen e mineralit gur gatro, siç është në lejen përkatëse. Tani, procedura sipas kësaj VKM në kreun 2.1 thotë: personi fizik ose juridik që kërkon të kryejë procedurën për ndryshimin e kategorisë së përdorimit dhe pakësimin në volum të një sipërfaqe nga fondi pyjor kombëtar, bën kërkesën nëpërmjet portalit e Albania, që e arkivon Ministria e Mjedisit në këtë rast. Pika 5 e po këtij kreu thotë: struktura përgjegjëse për pyjet në ministri nëse vlerëson se dokumentacioni është i plotë sipas pikës 2 të kreut 3 të këtij vendimi dhe është në përputhje me rastet e përcaktuara në pikën 14 të këtij kreu, përcjell kërkesën për hartimin e raportit tekniko-ekonomik dhe dhënien e dakordësisë nga ana e njësisë vendore përkatëse, në këtë rast, kur sipërfaqja pyjore objekt i ndryshimit të kategorisë së përdorimit është në pronësi të saj ose në pronësi private. Ashtu siç e keni materialin përpara, është hartuar raporti teknik që janë nxjerrë sipërfaqet sipas kadastrës dhe normalisht njësia e qeverisjes vendore brenda 30 ditëve do të shqyrtojë dhe del me vendim të këshillit bashkiak për dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave, që kjo në rastin tonë do të bëhet me vendim të

këshillit të ministrave, duke qenë se kalon, sipërfaqja është 6.7 hektarë dhe për sipërfaqet nga 1 hektar deri në 10 hektarë bëhet me vendim të këshillit të ministrave. Mbi 10 hektarë bëhet me ligj të veçantë dhe deri në 1 hektarë bëhet me urdhër ministri. Nuk e di, ndonjë gjë tjetër? Dokumentacioni është i plotë sipas akteve në fuqi.

-U largua këshilltari Tonin Jaku.

-Ndue Luli: Atëherë, ka ndonjë mendim tjetër? Zoti Tushaj ka fjalën.

-Pjeter Tushaj: Faleminderit zoti kryetar. Mua më kujtohet që këtë projektvendim që e kemi për të kaluar sot, ne para një viti na kanë pranuar për t'ia kaluar ministrisë për miratim. Tashi, dy fjalë po them unë, që si ka mundësi që atëherë e miratuam dhe tash paska parregullsi. Unë s'e kuptoj fare. Unë mendoj që ta kalojmë këtë projektvendim.

-Ndue Luli: Faleminderit zoti Tushaj. Po, zonja Ndoj.

-Donika Ndoj: Po kështu i bie që këto projektvendimet ne mos t'i kalojmë tek komisionet kur mbledhet komisioni. Kështu që unë besoj për sa kohë kur flasim për dokumentacion të plotë, që sapo e lexoi edhe Artani, për kur flasim për dokumentacion të plotë, të paktën duhet të ishte edhe pasqyruar këtu, e zeza në të bardhë mbetet e shkruar. Kështu që edhe qytetarët, edhe ne si këshilltarë jemi të sqaruar edhe themi se po, okej, le të kalojë ky fond pyjor, por ama edhe qytetarët kanë këto benefite, një, dy, tre dhe s'ka nevojë pse të komplikohet aq shumë diskutimi. Gjithsesi, unë për sa kohë komisioni është dakord që mos me kalu, unë nuk do ta votoj. Faleminderit.

-Ndue Luli: Qartë, faleminderit. Tjetër? S'ka. Atëherë, e thashë që në fillim dhe do ta zbatoj se është rregullsi. Kush është dakord me propozimin që ka komisioni i bujqësisë për shtyrjen e këtij projektvendimi mbledhjen e radhës? Ama do të sqaroj edhe vetë, unë do ta justifikoj votën time. Kush është për shtyrje? Një, dy, tre, katër, pesë..... etj. Atëherë ky projektvendim nuk mund të miratohet, sepse këtu ishin pesë dakord për shtyrje, tre ishin kundra, këshilltarët Elsa Gazulli, Gjon Marku, Flutura Gjoni dhe për ta miratuar këtë projektvendim duhen 25 vota. Dakord, këshilltarë?

Ta sqaroj, të gjitha projektvendimet që kanë të bëjnë me tjetërsim pronash duan 25 vota pro që të miratohen dhe kjo është një tjetërsim prone që e kemi bërë dikur, ka të drejtë zoti Tushaj që e thotë, por përderisa komisioni i bujqësisë nxjerr në dukje që në relacion nuk paraqiten ato benefitet që i vijnë komunitetit, që i vijnë bashkisë me shifra, atëherë pse mos ta shtyjme ne? A duhet ta respektojmë komisionin? Ne nuk zbatojmë çfarë thotë komisioni, e vendosim ne si këshill, por për momentin kjo është më mirë se, e di kush merret me këshillat bashkiake, në qoftë se ne nuk e miratojmë sot këtë projektvendim, kalojnë muaj të tërë dhe nuk e marrim në shqyrtim, sepse nuk e lejon ligji. A e kuptoni dhe këtë tjetren?

-Flutura Gjoni: Po i marrim 20% firmës, por na gjeni bazën ligjore.

-Brikena Vuksani: Se do vijmë këtu pastaj e s'e votoni se ku është baza ligjore për 10%, për 20%. Të ardhurat që i vijnë bashkisë nga ky projekt janë të sqaruara në relacion.

-Ndue Luli: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, pika 6, Projekt-Vendim “Për miratimin e krijimit të një “kafeterie leximi” si dhe dhënies me qira të ambientit me vendndodhje në pjesën anësore në katin e parë të bibliotekës publike “Gjergj Fishta” me sip. 115.6 m² pjesë e pasurisë nr. 9/32, ZK 8631, pronë e Bashkisë Lezhë, për një afat 1 (një) vit”.

Fjalën e ka kryetari i komisionit.

-Agostin Marku: Faleminderit. Ishte një projektvendim i cili hëngri shumë kohë në komisionin juridik, komisionin e financës. Ishin të pranishme dy drejtori kryesore, drejtorja e kulturës dhe drejtorja e aseteve, që unë dua t'i falënderoj për gjithë informacionin që dhanë dhe na ndihmuan jashtëzakonisht shumë që ne të nxjerrim konkluzione të qarta për vendimmarrjen. Është diçka shumë pozitive që ne krijojmë mundësinë me një aktivitet të ri në bibliotekë, që në fakt në ideimin e atij institucioni, e asaj godine ka qenë i tillë, pavarësisht se nuk ka funksionuar. Është pozitive. Në bibliotekë janë rritur jashtëzakonisht shumë aktivitetet promovuese të cilat kanë nevojë edhe për këtë shërbim, që ky shërbim deri më sot është improvizuar në institucionin përkatës. Janë saktësuar mjaft mirë edhe kriteret, çështjet që ky aktivitet mos të dalë jashtë asaj që në fakt është ngritur, funksionet që do të ketë, që t'i shërbejë të gjithë klientëve, të gjithë funksionarëve që do të zhvillojnë aktivitete aty, pse jo edhe grupeve të artistëve për kohën e lirë, për punën dhe për gjithçka tjetër. Dhe ne mendojmë se do të ketë produktivitet. Në parim si komision ishim dakord, do të bëjmë vetëm ca rregullime në vendim, të cilat unë po jua them. Që janë: te pika 2, për ne nuk duhet të jetë emri i subjektit, se ne nuk miratojmë subjektin si këshill. Ne miratojmë në parim çështjen e aktivitetit dhe dhënies me qira, atë që na përcakton ligji. Tek pika 3, s'duhet ta vendosim vlerën e qirasë mujore me këtë vlerë që thuhet, kjo është vlera në fakt, por paketa fiskale i nënshtrohet shumë herë ndryshimeve dhe ne jemi në prag të paketës së re fiskale. **(Ndërhyn zv/kryetarja e bashkisë duke thënë që vlera e qirasë është me ligj të veçantë)** Dhe ne mendojmë që të jetë, se i reziston më mirë, vlera e qirasë mujore të jetë sipas paketës fiskale në fuqi, edhe s'bëjmë asgjë në kundërshtim me ligjin. Duke rregulluar këto dhe duke shpresuar që edhe në të ardhmen, pasi ne ta kalojmë pra si vendimmarrje, bashkia do të ndërtojë ca standarde dhe do të ndjekë mirë gjithë aktivitetin që mos të dalë jashtë kushteve të kontratës dhe t'i shërbejë me gjithë mend atij qëllimit që ka bashkia për t'i shërbyer qytetarëve me këtë aktivitet të ri në bibliotekën e qytetit. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Kush e do fjalën tjetër? Po zonja Marku.

-Alfrida Marku: Faleminderit. Atëherë, unë e vlerësoj jashtëzakonisht shumë këtë iniciativë, ashtu sikurse gjej rastin që të përgëzoj drejtorinë e kulturës për menaxhimin e shkëlqyer dhe dinjitoz të muajit të aktiviteteve dedikuar Atë Gjergj Fishtës gjatë muajit tetor, aktivitete që për hir të së vërtetës, përveçse dinjitoze në aspektin organizativ, kanë qenë edhe gjithëpërfshirëse dhe kjo duhet vlerësuar më së shumti.

Sa i përket këtij projekti, siç edhe e thashë, e vlerësoj sepse ka si qëllim të afrojë lexuesin me librin dhe jo vetëm kaq, të krijojë lehtësi për aktivitetet e shumta promovuese që po zhvillohen në bibliotekën Atë Gjergj Fishta të qytetit të Lezhës.

Gjatë mbledhjes së komisionit dje, edhe pse nuk jam pjesë e komisionit me të drejtë vote, por kam të drejtë të shpreh mendimet, kam sugjeruar që Bashkia Lezhë t'i japë rëndësinë e duhur nënshkrimit të marrëveshjes me subjektin, me qëllim që ky aktivitet të ketë në themel qëllimin social të tij dhe të mos mbizotërohet nga ana komerciale. Pse e them këtë? Duhet pasur parasysh disa elementë që mendoj unë e bëjnë diferencën, të tilla si të vendosen çmimet tavan, të vendoset lista se çfarë do të shërbehet në këtë kafeteri dhe çfarë nuk do të lejohet, për shembull, mos lejimi i pijeve alkoolike. Pra, janë disa elementë të cilat unë mendoj që duhet të kihet parasysh. Bashkia Lezhë të ketë vëmendjen e duhur me qëllim që kjo kafeteri të mos kthehet në një bar të zakonshëm, por të ketë në themel aspektin social, shërbimin drejtuar lexuesit dhe lehtësitë për aktivitetet që zhvillohen aty. Faleminderit.

-U largua këshilltari Pjeter Tushaj.

-Ndue Luli: Faleminderit. Tjetër? Kush e do fjalën? Fjalën e ka zëvendëskryetarja e bashkisë.

-Eueda Molla: Përshëndetje të gjithëve. Absolutisht, pas kalimit të këtij projektvendimi për krijimin e kafeterisë së leximit, do të bëhet një kontratë me subjektin i cili do të shpallet fitues dhe do të jenë të gjitha kriteret që do të vendosen nga drejtoria e kulturës për të mos cënuar absolutisht funksionimin e asaj kafeterie dhe aq më shumë të mos cënohet funksionimi i bibliotekës.

-Ndue Luli: Faleminderit. Tjetër? Atëherë, kush është dakord me projektvendimin me ndryshimet që u thanë? Miratohet me 22 vota Pro. Këshilltarët Dod Jaku, Donika Ndoj, Emanuel Perjaku votuan Kundër, 3 vota Kundër. Faleminderit.

Vazhdojmë me pikën 7, Projekt-Vendim "Për miratimin e marrëveshjes së subvencionimit ndërmjet programit URBACT IV 2021-2027 dhe Bashkisë Lezhë për projektin "URBACT PIONEERS ACCELERATOR".

Fjalën e ka kryetari i komisionit.

-Agostin Marku: Shkurtimisht, është një projektvendim që lidhet me pikën 3 të rendit të ditës që ne e hoqëm nga shqyrtimi sot, pikërisht për këtë qëllim që të miratojmë pikësëpari këtë.

Është një program shtesë nga fondet e Bashkimit Europian që i shërben Bashkisë Lezhë. Është gjë pozitive. Sa më shumë të kemi projekte të tilla dhe të na vijnë për vendimmarrje në këshillin e bashkisë, aq më mirë është. Dhe unë ju ftoj që ta miratojmë këtë marrëveshje. Faleminderit.

-Ndue Luli: Ka kush ndonjë mendim? Po zonja Gjoni.

-Flutura Gjoni: Na flisni pak për këtë projekt.

-Brikena Vuksani: Ky është një nga shumë projektet që Bashkia Lezhë ka aplikuar dhe është shpallur fituese përgjatë këtij viti. Ky projekt është shpallur fitues nga programi i URBACT-it. Ka në qendër dhe në fokus turizmin, ku në total si program, si projekt është 30.000 euro, nga të cilat bashkëfinancimi i Bashkisë Lezhë është 1.750 euro dhe pjesa tjetër mbulohet nga donatori. Fillon programi, pavarësisht se në kontratat e subvencionit është e shkruar nga fillimi i vitit

2025, ky fillon me nënshkrimin e kësaj kontrate që ne kemi bërë në shtator të këtij viti dhe me miratimin në këshill do fillojnë dhe aktivitetet përkatëse. Siç e thashë, në qendër të këtij projekti është turizmi, ku do të bëhet zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm, bashkëpunimi midis Bashkisë Lezhë edhe bashkive të tjera europiane. Në fund fare të këtij projekti do të ketë edhe një investim në infrastrukturën për turizmin, i cili është duke u përgatitur projekti për të dhe do ta aplikojmë në fund të projektit, kryesisht në promovimin e turizmit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Tjetër ka? Nuk ka. Kush është dakord me projektvendimin? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve present, 25 vota Pro. Faleminderit.

Vazhdojmë me pikën 8, Projekt-Vendim “Për emërtimin e rrugës me nr. 57 03170051 me emrin “Gjergj Kovaçi” në fshatin Tresh, Njësia Administrative Zejmen”.

Para se të flasim për këtë, duhet të tregoj se Njësia Administrative Zejmen ka paraqitur kërkesat për emërtimin e këtyre rrugëve, duke qenë se ato nuk kanë pasur emërtime, vetëm me numra, siç e shikoni. Për këto rrugë është bërë edhe një dëgjese publike, të cilën dëshiroj që mos të na përsëriten dëgjesa të tilla. Me ata këshilltarë që ishim atje, kemi biseduar, kështu që them se do të ndërgjegjësohet edhe komuniteti që dëgjesat publike të jenë tamam të mirëorganizuara nga njësia administrative, por edhe nga ana jonë do të jenë vërtet korrekte.

Në lidhje me këtë, kush e do fjalën? Nuk ka. Atëherë, kush është dakord me projektvendimin? Miratohet me 24 vota Pro. Këshilltarja Alfrida Marku nuk votoi.

Kalojmë te pika 9, Projekt-Vendim “Për emërtimin e rrugës me nr. 46 03170040 me emrin “Jak Kovaçi” në fshatin Tresh, Njësia Administrative Zejmen”.

Kush është dakord? Miratohet me 24 vota Pro. Këshilltarja Alfrida Marku nuk votoi.

Kalojmë te pika 10, Projekt-Vendim “Për emërtimin e rrugës me nr. 60 03170055 me emrin “Pjetër Jak Zefaj” në fshatin Tresh, Njësia Administrative Zejmen”.

Edhe për këtë, kush është dakord? Miratohet me 24 vota Pro. Këshilltarja Alfrida Marku nuk votoi. Faleminderit.

Kemi informacionin që keni pasur të gjithë mbi realizimin e buxhetit për 9-mujorin e vitit 2025. Në lidhje me informacionin, në qoftë se ka ndonjë problematikë nga këshilltarët, mund ta ngremë. Atëherë fjalën e ka nënkryetarja e bashkisë.

-Brikena Vuksani: Atëherë, në lidhje me raportin për monitorimin e zbatimit të buxhetit për 9-mujorin e vitit 2025, ku paraqiten realizimi i të ardhurave dhe realizimi i shpenzimeve, kryesisht për të ardhurat për 9-mujorin, janë 58.6%. Mund të themi këtu se shumica e taksave dhe tarifave vendore janë arritur dhe janë realizuar. Janë realizuar në masën 90 deri 100% për pjesën e taksave, gjithashtu edhe për pjesën e tarifave në masën 92.6%. Pjesa e mosrealizimit që ndikon edhe tek pjesa tjetër që nuk realizohet është taksa e ndikimit në infrastrukturë, e cila gjatë këtij muaji, tetor, ka pasur disa arkëtime dhe presim që deri në fund të vitit të ketë realizimin e plotë sipas planifikimit të buxhetit.

Gjithashtu, edhe për pjesën e realizimit të shpenzimeve, pjesën më të madhe të realizimit e kanë pagat në 83%, pjesën e shpenzimeve operative 45% dhe pjesën e realizimeve faktike të investimeve janë në masën 22%. Kjo për arsyen se të gjitha investimet që Bashkia Lezhë ka pasur të buxhetuara në projektbuxhetin e vitit 2025, të gjitha kanë filluar procedurat dhe pjesa më e madhe janë duke përfunduar. Për shembull, rrugët rurale në të gjitha njësitë administrative janë drejt përfundimit. Tani, së shpejti, për pak ditë do fillojnë edhe rrugët urbane, varrezat e reja të qytetit, shkolla “Gjergj Fishta” që ka nisur punën, rikonstrukcioni i kopshteve të njësive administrative, muzeu në Kala që presim të mbarojë brenda muajit dhjetor dhe të gjitha investimet sipas buxhetit janë realizuar. Presim vetëm që të jetë tek informacioni i raportimit edhe buxheti faktik, domethënë pagesa e situacioneve dhe faturave. Po, pagesa bëhet edhe pjesore, kjo për shkak edhe të procedurave që kanë nisur me vonesë, sepse ne i nisëm procedurat pas zgjedhjeve dhe gjithësesi dhe procedurat marrin kohë. Se të gjitha këto janë investime të mëdha dhe kërkojnë kohën, pjesën e përgatitjes së dokumentacionit, shqyrtimit të dokumentacionit, fillimit të afateve për këtë. Edhe, domethënë, situata ekonomike e bashkisë tani paraqitet e mirë. Përveç kësaj, sot jemi në 65% realizimi i të ardhurave, duke përfshirë dhe muajin tetor që po përfundojmë tani. Edhe gjendja në arkë e të ardhurave të bashkisë është e mirë. Vetëm presim që të kemi dokumentacionin që të bëjmë likuidimet përkatëse. Ne po përpiqemi që një pjesë është bërë gjatë muajit tetor, pjesa tjetër do realizohen gjatë muajit nëntor. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit, zëvendëskryetare. Kalojmë te pika të ndryshme. Para se t’ju jap fjalën për problematikat që keni, duhet të njoftoj gjithë këshillin se me datën 6 nëntor, në orën 11:00, në sallën e bibliotekës, kemi një aktivitet organizuar edhe nga projekti “Bashki të Forta” për bashkëpunimin efektiv të këshillave bashkiake me shoqërinë civile. Ju lutem që të jeni pjesëmarrës në këtë takim, pasi jemi ne ata që jemi të zgjedhur nga komuniteti, që do të shprehim edhe mendimet tona në lidhje me punën që bëjmë ne si anëtarë të këshillit bashkiak për të sjellë zërin e komunitetit në këshill.

Po, zonja zv/kryetare.

-Brikena Vuksani: Ne nga data 10 deri me datën 13 kemi vendosur që të organizojmë dëgjесat publike për buxhetin dhe për paketën fiskale, domethënë për PBA 2026-2028, edhe do i isha lutur të gjithëve që të ishin pjesëmarrës në dëgjесat publike që do të organizohen për buxhetin.

-Ndue Luli: Faleminderit. Kush e do fjalën? Te pika “Të ndryshme” jemi. Zonja Gjoni.

-Flutura Gjoni: Qytetarëve të Lezhës u ka ardhur fatura si qytetar për ta paguar. Vjen dy herë taksa e ndërtesës, edhe taksa te fatura, edhe taksa te ujësjellësi. Bëni këtë evidentimin. Ata që kanë faturë me ujësjellësin nuk do ta paguajnë, mos ua çoni. Nuk besoj se janë shumë. Kam përshtypjen është e realizueshme. Pra, mua më ka ardhur dy herë. E kam paguar dy herë. E kam zgjidhur, por për qytetarët.

-Brikena Vuksani: E kam dokumentacionin e ndarë, pjesën që paguajnë me ujësjellësin familjar dhe që nuk janë me ujësjellës sipas të gjitha njësive administrative. Do ta verifikoj problematikën.

-Ndue Luli: Faleminderit zonja Gjoni. Zonja Marku.

-Alfrida Marku: Atëherë, në këtë pjesë unë do adresoj disa problematika që vijnë nga komunikimi me qytetarët. Pavarësisht se nuk është drejtpërdrejt kompetencë e bashkisë, unë kërkoj vëmendjen e Bashkisë Lezhë që ta adresojë te institucionet përgjegjëse problemin e ndërprerjes së vazhdueshme të energjisë elektrike në njësinë administrative të Balldrenit.

Së dyti, një problematikë tjetër që vjen nga qytetarët është mosgjetja zgjidhje e pagesave të dëmeve nga tërmeti. Pra, Bashkia Lezhë dhe këshilli bashkiak kanë gjetur zgjidhje për rindërtimin e banesave që ishin vendimet e muajit të kaluar, por që janë disa pagesa të tjera për dëmet e kategorizuara të ardhura nga tërmeti dhe që për këtë janë qindra familje, në fakt, të cilat nuk kanë gjetur ende zgjidhje.

Një problem tjetër që vjen nga qytetarët është vëmendja për pastrimin e varrezave në të gjitha njësitë administrative. Aq më tepër që tashmë jemi në edhe afër datës 2 nëntor, që është data që ne të gjithë kujtojmë të dashurit tonë që nuk jetojnë më. Pra, kërkoj bashkisë në të gjitha njësitë administrative që të ketë në vëmendje pastrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave.

Një problematikë tjetër është mosgjetja zgjidhje ende e problemit të oborrit midis të dy shkollave, "Gjergj Kastrioti" dhe "Besëlidhja". Janë dy shkolla me nga 700 nxënës, të cilat ndajnë një oborr të vetëm, ndërkohë që ka mundësi për të gjetur zgjidhje, si dhe parkimi i makinave në hyrje të shkollës "Gjergj Kastrioti". Unë e kam komunikuar këtë problematikë edhe me nënkryetarin e bashkisë. Ka patur vullnet për ta zgjidhur, por unë zgjidhje e konsideroj zgjidhje përfundimtare dhe jo të përkohshme. Kështu që kërkoj vëmendjen tuaj që në hyrjen e shkollës "Gjergj Kastrioti" të ndalohet në mënyrë rigoroze parkimi i makinave, pasi mund të shkaktojë ngjarje të rënda që unë as nuk dua t'i çoj nëpërmend.

Një tjetër problematikë, në fakt, përfaqësuesit e drejtorisë së bujqësisë ikën, por ne në fillim të këtij viti kemi diskutuar shumë për problemin e vonuar të çertifikimit të pronave nga në përdorim në pronësi. Është një problem i zvarritur, kryesisht nga ngërçi institucional i shkaktuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës. Janë rreth 800 familje, në mos gaboj, sipas shifrave të referuara nga drejtorja e bujqësisë, që ende s'kanë gjetur zgjidhje.

Problem tjetër që vjen sërish edhe ky nga qytetarët është banjot publike në qytetin e Lezhës. Kështu që unë mendoj që ne si këshill bashkiak duhet ta adresojmë si problematikë. Faleminderit.

-Brikena Vuksani: Unë kam një përgjigje për pjesën e sistemimit të varrezave nëpër njësitë administrative. Vetëm pak shkurt e kam. Aktualisht janë gjithë punëtorët e njësive administrative duke u angazhuar me këtë pjesë, sepse e dimë edhe ne që është pjesa që duhet të kryhet para datës 1 nëntor. Faleminderit.

-Ndue Luli: Fjala për zotin Gjinkola.

-Pjeter Gjinkola: Unë kam dy probleme për në zonën e Shëngjinit. E para është se ka filluar një shqetësim, që, me thënë të drejtën, ishalla nuk shkon në vazhdimësi kjo punë, se unë e quaj shumë shqetësim. Ka filluar fikja e dritave në mënyrë kohë e pa kohë në Shëngjin, fenomen që s'ka qenë më parë dhe është shumë i theksuar. E para.

E dyta kam që kam problem unë për një familje në Shëngjin, ku e kam bindje absolute se asaj familje në Shëngjin i bihet në qafë. Është rasti i familjes së Ilir Currit në lagjen Sakë. Aty kanë shkuar të gjitha grupet. Unë i kam marrë, bile kam marrë dhe kryetarin, kam marrë dhe zotninë e shërbimeve publike, kam marrë edhe të tjerë. Kam folur edhe me nënkryetarin për këtë problem dhe është një problem se atje shkojnë njerëzit, i thonë e kena pa, e dimë është shkak knalla, domethënë niveli i ujit dhe tash këtij i bëhet padrejtësi, jam i sigurt vetëm për arsyen e atyre të tjerëve, ky ka bërë shpinë para se janë bërë pallatet atje dhe atëherë ndodh vetëm se nuk çojnë një skavator me pastru pak më shumë kanalin. I kanë thënë atij që shko ti hidh çakull, rrit nivelin e oborrit. Ai nuk mund të qesin nivelin e oborrit mbi shkallët e shpisë. Kështu që ju kërkoj institucionit të bashkisë të jenë më seriozë dhe të shkojnë në vend aty edhe po qe nevoja shkoj edhe unë e të ketë edhe një grup që ta verifikojë këtë punë, se unë e kam bindje se atij si familje, po i bihet në qafë në kuptimin social që nuk janë shumë të preokupum me i dhënë zgjidhje. Atij i hyn uji mren sa herë bie shi.

-Ndue Luli: Faleminderit. Zoti Jaku.

-Dod Jaku: E kam ngritë edhe herë të tjera problemin e energjisë elektrike. E kanë ngritë edhe kolegë të tjerë. Ne kemi zona të tilla në Bregun e Matës siç është Myltja që edhe me tre katër ditë edhe me javë pa energji elektrike. Sot në këtë kohë dhe në këto kushte është skandaloze. Unë them që shqetësim e kanë të gjithë, e ka gjithë Lezha, mund ta kenë shumë zona të Shqipërisë. Ne duhet të ngremë zanin tonë sa të mundemi për këtë problem. Është shumë shqetësim. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit ju. Zoti nënkryetar.

-Fatjon Zefi: Po i marr pak me radhë.

Në lidhje me procesin e rindërtimit, faza e fundit, të gjithë ata që janë shpallë përfitues me vendim të këshillit bashkiak, bashkia i ka përcjellë disa herë ministrisë së rindërtimit kërkesë për alokimin e fondeve, por akoma nuk kemi një përgjigje dhe ne nuk mund të shprehemi nëse do bëhet apo s'do bëhet. Pra ne e kemi kryer detyrën tonë edhe ju si këshill bashkiak. Pra jemi në pritje.

Në lidhje me shkollën "Gjergj Kastrioti" për atë problemin e parkimit në hyrje të shkollës, e kemi diskutuar me këshilltaren, është e pamundur që ne ta bllokojmë në mënyrë të përhershme, pra që të vendosim një pengesë aty, sepse ka raste kur është e detyruar të hyjë zjarrfikësja ose ambulanca dhe mund të ketë probleme kritike që mund të na çojnë në një problem më të madh sesa çështja e bllokimit të rrugës. E çmontueshme, por në momentin që ambulanca duhet të vijë

në çështje në kohë rekord, ne nuk na premtan koha. Nuk mund të lëmë një roje. Gjithsesi ne do bëjmë maksimumin me policinë bashkiake që kemi komunikuar që ta pengojmë.

Në lidhje me energjinë elektrike, Bashkia Lezhë bën maksimumin në ndihmë të këtij procesi, duke iu vënë në dispozicion shpesh herë fadromën, vinçin, koshin. Pavarësisht se nuk është detyra jonë, ne bëjmë maksimumin që qytetarët të marrin shërbim. Pra e bëjmë jashtë kompetencave tona, i vijmë në ndihmë. Edhe komunikimet besoj se si administratorët, si ne e kemi, kur qytetarët na marrin telefon dhe na ankohen, mundohemi të komunikojmë sa më shumë me OSHEE-në që problemet të zgjidhen sa më shpejt.

Familja e Ilir Currit, në lagjen Sakë, është e vërtetë. Ne edhe vjet kemi shkuar aty me të gjitha grupet, emergjencat, drejtorja e bujqësisë, kadastra, kemi bërë të gjitha verifikimet dhe problemi qëndron kështu. Aty është ndërtu siç është ndërtu komplet zona e Kunes dhe të gjithë. Ai është me leje legalizimi, nuk është me leje ndërtimi, nuk është tashi se po i vë faj atij unë dhe është i ndërtuar nën kuotë. Ideja është të hapim kanale komplet, në qoftë se hapim kanal komplet knalla i hyn në shtëpi atij. Pra shtëpia e tij është poshtë nivelit të knallës. Është bërë verifikimi i kësaj pune. E dyta, në hartën e hipotekës, prona e tij nuk lidhet në asnjë vend me kanal kullues. Pra është i rrethuar me prona private dhe nuk kemi asnjë mënyrë. E treta, ne s'mund të bëjmë hidrovor 1 milion euro për Ilir Currin, as për Fatjonin, as për kërken. Ne e kemi njoftu, i kemi thënë, vëmë në dispozicion që t'ia ngrejme nivelin që të paktën të ketë akses në shtëpi dhe këtë ai nuk e pranon. Tani ne s'mund të bëjmë mrekulli, as nuk mund të ngrejme nivelin e shtëpisë. Tjetra, ai ka bërë disa marrëveshje personale me palë të treta të cilat nuk mund t'i shqyrtojmë ne. Pra ka ndërhyrë në pronën e tij me dëshirën e tij ka bërë ndërhyrje. Prandaj ne s'jemi Zoti që ta ngrejme shtëpinë e tij në ajër. Ne mund t'i ofrojmë strehim në një vend tjetër. Këtë nuk e pranon.

-Ndue Luli: Fjalën e ka zoti Noka.

-Pjeter Noka: E kam ngritë një 2-3 herë si shqetësim, llampat te ura e re.

-Fatjon Zefi: Do t'i vëmë ato llampa, është e vërtetë që më ke thënë. Blerja që ka bërë drejtorja e shërbimeve nuk përshtatet me ato llampa. Ne nuk bëjmë blerje me lekë në dorë. Realisht nuk kushtojnë shumë ato llampa. Kemi apliku dhe te Fondi i Zhvillimit dhe e kemi fitu një projekt për të marrë disa materiale shtesë që do t'i përdorim. Çështje ditësh do ta zgjidhim.

-Ndue Luli: Falemiderit për pjesëmarrjen. Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Shënim: Mbledhja u transmetua live në Facebook në faqen "Këshilli i Bashkisë Lezhë".

SEKRETARI

Floride Gungaj
8

KRYETARI

NDUE LULI
[Signature]